



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:205129  
Datë: 19.12.2024  
Numri i dokumentit: 06628470

**K.DH.SH.II.nr.1902/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit "The Trio" me NRB 810169202, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Argjent Sefa, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1102/24 të datës 12.08.2024, me datën 12.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit "The Trio" me NRB 810169202, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1102/24 të datës 12.08.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar, në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit The Trio" me NRB 810169202 i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.911/24 të datës 05.06.2024 i lejuar nga Përmbartuesi Privat dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitive te procedurës përmbartimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar te Priset dhe te anulohet Urdhri përmbartimor apo te ndërkrehet procedura ne kete çështje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, përmbartuesi i privat me datë 17.05.2023, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.911/24 të datës 05.06.2024 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Vendimit të Inspektoratit të Punës NR.02V-148-23/2262 të datës 05.11.2023, me të cilin është obliguar debitori që në emër të gjobës, t'i bëj pagesën kreditorit në shumën prej 5,400€.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është lëshuar ky urdhër nuk është dokument që i plotëson kushtet për përmbartim sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP-së) ashtu siç edhe ceket me dispozitat e këtij ligji.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se përmbartuesi me urdhrin përmbartimor ka vërtetuar se vendimi i kreditorit është dhënë në procedurë administrative dhe si i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë. Më tej ka shtuar se vendimi i tillë është i besueshëm, i përmbartueshëm dhe i ekzekutueshëm dhe se ushtrimi i padisë në konflikt administrativ pranë gjykatës nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Pare-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, të Përmbartuesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës NR.02V-148-23/2262 të datës 05.11.2023 në bazë të së cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/56-209/23-GJ, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimit të Inspektoratit të Punës NR.02V-148-23/2262 të datës 05.11.2023, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 04.03.2024, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Janë të pabazuar pretendimet e debitorit të ankese që të ndërkrehet procedura në këtë lende pasi ka paraqite padë në konflikt administrative për arsye e se padia në konfliktin administrativ në baze të nenit 22 të LKA nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit administrative në rastin konkret të inspektoratit të punës.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.1902/24 me datë 12.12.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi